



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:073248

Datë: 20.02.2024

Numri i dokumentit: 05347919

C.nr.633/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.K. nga fshati .... Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro, më datë 20.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

I. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit I.K. nga fshati ..... Komuna e Rahovecit, për shkak të kompensimit të dëmit material, me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Scardian”, me seli në Prishtinë, që paditësit, t’ia kompensoj dëmin material automjet në shumë prej 1,000.00 euro, dhe atë me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë më datë 13.04.2021 e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi I.K. nga fshati ..... Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro.

I autorizuari i paditësit av. D.M. në seancën përgatitore të datës 20.02.2024, ka deklaruar se pasi që me palën e paditur sot më datë 20.02.2024 kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, në kuptim të dispozitave ligjore të LPK-së, heqë dorë nga kërkesëpadia dhe i propozoj gjykatës marrjen e aktgjykimit për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, në përputhje me nenin 149 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t’i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:073248  
Datë: 20.02.2024  
Numri i dokumentit: 05347919

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.633/2021, datë 20.02.2024

Gj y q t a r i

---

Uran Zogaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.